

Pr. 13767 30.9.2020



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 37 datë 25.9.2020

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE GJYQËSORE

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 25.9.2020, me propozim të një këshilltari, bazuar në nenin 54 germa "h", nenin 55 pika 2 të ligjit nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; nenit 12, pika 1, germa "h" të rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e këshillit bashkiak Shkodër", me 33 vota Pro,

V E N D O S I:

1. Fillimin e procedurave gjyqësore për ngritjen e kërkesë-padive kundër vendimeve të Kryetares së Bashkisë Shkodër nr.3, datë 1.6.2020 "Për miratimin e pasqyrave financiare të vitit 2018, të shoqërisë Klubi i Futbollit "Vllaznia" sh.a., nr.10, datë 22.7.2020 "Për zëvendësimin dhe emërimin e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë Klubi i Futbollit "Vllaznia"sh.a.

Detyrimin e Administratorit të K.F.Vllaznia, për depozitimin pranë QKR, të akteve të miratuara nga Këshilli Bashkiak Shkodër, në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme të K.F.Vllaznia sh.a., me datë 29.5.2020.

- Vendim nr.2, datë 29.5.2020 "Për miratimin e pasqyrave financiare të vitit 2018, të shoqërisë aksionare K.F.Vllaznia sh.a.
- Vendim nr.3, datë 29.5.2020 "Për emërimin e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë aksionare K.F.Vllaznia sh.a.

Detyrimin e QKB të çregjistrojë nga regjistri vendimet e Kryetares së Bashkisë Shkodër nr.3, datë 1.6.2020 "Për miratimin e pasqyrave financiare të vitit 2018, të shoqërisë Klubi i Futbollit "Vllaznia" sh.a., nr.10, datë 22.7.2020 "Për

zëvendësimin dhe emërimin e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë Klubi i Futbollit "Vllaznia"sh.a.

Detyrimin e QKB të regjistrojë aktet e miratuara Këshilli Bashkiak Shkodër, në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme të K.F.Vllaznia sh.a., me datë 29.5.2020.

- Vendim nr.2, datë 29.5.2020 "Për miratimin e pasqyrave financiare të vitit 2018, të shoqërisë aksionare K.F.Vllaznia sh.a.
 - Vendim nr.3, datë 29.5.2020 "Për emërimin e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë aksionare K.F.Vllaznia sh.a.
2. Ngarkohet dhe autorizohet Sekretari i Këshillit Bashkiak Shkodër të kryej të gjitha veprimet e nevojshme administrative dhe gjyqësore, lidhur me objektin e padive.
 3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Sekretar i Këshillit



Denis Lesha

KRYETARE



Ersela KADIJA